

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje lëndë ngrohëse (Pellet) Briket për nevoja të Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan dhe Qendrat në Varësi të tij përkatësisht :
Shtëpiza e Mbrojtur “Jeta” Cërrik
Shtëpiza e Mbeshtetur “ Drita” pranë Qendrës Balashe Elbasan.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09110000-3, Lëndë djegëse të ngurta.

VLERA E FONDIT LIMIT: 31 792 262 (tridhjetë e një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Më datë 12.09.2023 njësia e prokurimit e ngritur me urdhër prokurimi Nr.554 prot më datë 16.08.2023 ,në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Psikiatrik ”Sadik Dinçi” Elbasan** ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e prokurimit me objekt:”Blerje lënde ngrohëse pellet ”, **Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, me CPV-KODI Produkte 09110000-3, Lëndë djegëse të ngurta, me Fond limit për 24 muaj.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Spitali Psikiatrik Sadik Dinçi Elbasan** , ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a)Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, në të cilën është e parashikuar se:

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.
2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

c) Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës 635.845(gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lek pa tvsh.

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;
- b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 **ose ekuivalente**, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia

e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshir në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

2.1.2 Organi i vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr. 667, datë 29.7.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit".

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit

nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së .

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si çertifikata ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të **paktën një vit të** periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.Shënim:Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40 % vlera e fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40 pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin

që prokurohet, në vlerëjo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën një mjet transporti të pershtatshëm për transportin e pelletit, me kapacitet mbi 2 (dy) Ton .)” e vertetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil, ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKR, etj

Kur automjeti është në pronësi të operatorit ekonomik të paraqitet:

Leja e qarkullimit

Polica e sigurimit

Kontrolli teknik vjetor

(ketodokumentaduhette jene te vlefshme ne daten e hapjes se ofertave)

Kur automjetieshtemarremeqerateparaqitet:

Leja e qarkullimit

Polica e sigurimit

Kontrolliteknikvjetor

Kontratenoteriale e marrjes se mjetitmeqera

(ketodokumentaduhette jene te vlefshme ne daten e hapjes se ofertave)

Për përmbushjen e dy kriterëve të mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi Nr.15, datë 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e lëndës djegëse pellet për ngrohje në objekte të shpërndara përkatësisht në qendrën Jeta Cërrik dhe Qendra Balashe , automjeti i mësipërm konsiderohet domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objekteve në të cilat do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1-Operatori Ekonomik fitues duhet te kete 4 kaldaja pelleti (2 cope kaldaja me fuqi 500-600 kw dhe 2 cope 100 kw), te vertetuara me dokumenta (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi) qe do te instalohen ne ambientet e spitalit psikiatrik Elbasan dhe qendrave ne varesi dhe do te jene ne perdorim deri ne perfundim te kontrates nga autoriteti kontraktor. Paisjet teknike (kaldajat dhe djegësi/bruciatorët) duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose në kontrata qeraje noteriale per gjithë periudhen e zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri AK kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën në rastin konkret **4 kaldaja pelleti** pasi vet Ak nuk disponon të tilla ,të cilat janë të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.2Ofertuesi , me një deklaratë nga ana e tij , të marrë përsipër riparimin e kaldajave në rast të ndonjë difekti të mundshëm gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri të vendosur AK kërkohet që operatorët ekonomikë të marrin përsipër difektet e mundshme të kaldajave të cilat do të jenë të angazhuara për përmbushjen e objektit të prokurimit në mënyrë që mos të ndërpritet shërbimi i ngrohjes për institucionin duke siguruar realizimin me sukses të kontratës.

2.3.3 Subjekti ofertues duhet te paraqese deklarate ne baze te se ciles merr persiper furnizimin me lëndë ngrohese me automjetin e tij dhe shpenzimet e tij deri ne vendin ku ndodhen magazinat e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri të vendosur AK kërkohet që operatorët ekonomikë të marrin përsipër furnizimin me lëndë ngrohëse meqënëse objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e lëndës djegëse pellet për ngrohje në objekte të shpërndara përkatësisht në Spitalin Psikiatrik Elbasan , Qendrën Jeta Cërrik dhe Qendra Balashe .

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportet e testimi ose fletë analizat nga laboratorë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë për produktin objekt prokurimi me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara. Dëshmia me rezultatet e testeve zyrtare duhet të jetë lëshuar jo më parë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Dokumentacioni për akreditimin e laboratorit i cili ka lëshuar fletë analizat e kërkuara do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Pë prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmitë testimet zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e lëndës djegëse pellet përngrohjenë, të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në pajisjet në të cilat do të përdoret (kaldaja me pellet), pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte pajisjet teknike.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion në paketim origjinal për produktin objekt prokurimi. Mostra e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostra duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara shih shtojcën (nr.5 tek specifikimet teknike)

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostër të mallit objekt prokurimi , deri më dt.04/10/2023, ora 11:00, në sekretarinë e Spitalit Psikiatrik , Elbasan, në prani të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Argumentim: Në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara si mostra duke u nisur nga pesha dhe rëndësia që ato kanë për mbarëvajtjen e proceseve të punës. Në këtë rast ky produkt është konsideruar si e nevojshme nga autoriteti kontraktor për t'u paraqitur mostra në paketim origjinal.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.6 Operatori ekonomik ne rastin kur nuk është prodhues i lëndes djegëse pellet, duhet të paraqesë kontrata furnizimi noteriale me prodhues të lëndes djegëse pellet, ose **edhe kontrata me distributor të autorizuar nga prodhuesi**. Pra AK lejon mundësinë që ofertuesi të paraqesë kontratat furnizimi edhe nga distributor I autorizuar nga prodhuesi.

Ofertuesi duhet të vërtetojë lidhjen e distributorit me prodhuesin.

Gjitashtu për rastet kur OE nuk është prodhues, duhet të paraqesë një vetëdeklarim që furnizuesi është conform standardeve të cilësisë, dhe AK ka të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, si dhe në rastin kur OE shpallet fitues, AK të kërkojë paraqitjen e certifikatave të kerkuara.

2.3.7 Lenda djegëse e kerkuar për furnizim do të levrohen nga kontraktuesi sipas kërkesave.

2.3.8 Kontraktuesi duhet të sigurojë furnizim të vazhdueshëm për 24 ore në ditë dhe sipas cilësisë së kerkuar.

2.3.9 Furnizimi me pellet nga ana e subjektit kontraktues do të behet prej orës 08:00 deri në orën 16:30, nga dita e hënë në të enjten, ndërsa ditën e premte deri në orën 14:00

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Argumentim: Në bazë të nenit të 70, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 41, pika 5 me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion kërkesat për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar nga komisioni i ngritur me urdher 442prot te dates 15.06.2023 duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme dhe duke u mbështetur në Skemën e Çertifikimit të cilësisë së lëndës djegëse Pelet sipas EPC (Këshilli European i Peletit) për kategorinë ENplus A1, sipas ISO 17225-2. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Kërkesat për paketimet, etiketimet dhe dokumentacionin shoqërues të mallrave objekt prokurimi janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi, referuar Ligjit nr. 10480 datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, Ligjit nr. 10489 datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe Ligjit Nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Skicimet, parametrat tekniketj:

Specifikimi i Materialeve:

plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

1. Malli objekt kontratë (briket pellet) duhet të jetë mall i cili përdoret vetëm për kaldajat.

Specifikimi i Materialeve:



Lënda djegëse pelet për ngrohje për kaldaja uji duhet të plotësojë këto specifikime teknike :

- 1.Paketimi 15 kg(ambalazh rezistent ndaj transportit)
- 2.Diametri 6 mm
- 3.Standart EN plus A 1
- 4.Përmbajtja e lagështisë 10%
- 5.Përmbajtja e hirit 0.2%
- 6.Vlera kalorike 5.36 KWh/kg
- 7.Dendesia 600-750 kg/m³

Të dhënat teknike të kaldajave të ujit me lëndë djegëse pelet që punojnë për ngrohjen e godinës së spitalit psikiatrik janë:

- | | |
|------------------------------|--------------------|
| 1.Fuqia | 500-600 KW |
| 2.Tensioni elektrik | 380 V |
| 3.Fuqia termike niminale | 500 KW-550KW |
| 4.Fuqia termike e kthyer | 480KW-520 KW |
| 5.Rendimenti | 80-87% |
| 6.Kapaciteti i silozit ditor | 1-2 m ³ |
| 7.Presioni i ujit | 1.5-4 bar |

Të dhënat teknike të kaldajave në lidhje me fuqinë e tyre kanë dalë si rezultat i volumeve në m³ të hapsirave (dhoma pacientësh,koridore dhe hapsira ndihmëse)të cilat janë të llogaritura nga projektuesit e godinës për realizimin e ngrohjes me kaldajat e tyre.

Për ngrohjen e spitalit do të përdoren dy kaldaja me fuqi 500-600 kw për (Spitali psikiatrik, Elbasan), 1(një) kaldajë me fuqi 100 kw në Streha e Mbështetur “Drita” pranë qendrës Balashe ,Elbasan dhe 1(një) kaldaje me fuqi 100 kë në Shtëpiza e Mbrojtur “Jeta”Cerrik. Tedyjaqendratjane ne varesitteSpitalitPsikiatrik.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit: 24 muaj nga nënshkrimi i marreveshjes kuader

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	PELLET BRIKET	433 728 KG	Spitali Psikiatrik Sadik Dinçi Elbasan dhe qendrat ne varësi	Nga momenti i nënshkrimit te draftit te marreveshjes kuader deri ne 24 muaj

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e Prokurimit

Gentjana Skënderi

Elisabeta Bezhani

Eraldo Hazizolli